

Udhëzimi nr. 13, datë 22.05.2019, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit ‘Mësues për Shqipërinë’”

Baza ligjore	Përshkruesit praktikë	Po/Jo	Komente
Kreu 1, Pika 2	Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve për mësues, si dhe pranimi në një vend të lirë pune janë realizuar nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”.		
Kreu 1, Pika 3	Procedurat janë udhëhequr nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, të drejtës për zgjedhjen e institucionit arsimor, barazisë dhe interesit më të lartë të nxënësve.		
Kreu 1, Pika 4	Procedurat sipas këtij udhëzimi janë zhvilluar vetëm për kandidatët që plotësojnë kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për ushtrimin e profesionit të mësuesit.		
Kreu 1, Pika 5	Drejtoria rajonale e arsimit parauniversitar (në vazhdim DRAP), ka organizuar procedurat sipas këtij udhëzimi.		
Kreu 1, Pika 7	Vendet e lira të punës janë shpallur, pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe sistemimi i mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (në vazhdim ZVAP), deri në një ditë para fillimit të vitit mësimor.		
Kreu 1, Pika 8	DRAP-i ka raportuar në DPAP lëvizjet paralele dhe vendet e lira të punës 1(një) ditë përpara fillimit të vitit mësimor.		
Kreu 1, Pika 9	DRAP-i ka konfirmuar menjëherë në portalin “Mësues për Shqipërinë”, përgjatë vitit mësimor, vendet e lira të punës për çdo institucion arsimor parauniversitar të varësisë, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës, brenda 5 (pesë) ditëve të para të çdo muaji.		
Kreu 1, Pika 10	DRAP-i dhe institucionet e varësisë kanë bërë publike vendet e lira të punës në portalin “Mësues për Shqipërinë”, në faqen zyrtare të tyre dhe në stendat e informimit publik.		
Kreu 1, Pika 11	DRAP-i dhe institucionet e varësisë kanë bërë publike menjëherë punësimet për çdo institucion arsimor në portalin “Mësues për Shqipërinë”, në faqen zyrtare të tyre dhe në stendat e informimit publik.		
Kreu 1, Pika 12	Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit, janë regjistruar online në portalin “Mësues për Shqipërinë”, sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vazhdim MASR).		
Kreu 2, Pika 1, Gërma a	Konkurrimi në portalin “Mësues për Shqipërinë” është zhvilluar me vlerësim me dosje		
Kreu 2, Pika 1, Gërma b	Konkurrimi në portalin “Mësues për Shqipërinë” është zhvilluar me testim të informatizuar.		
Kreu 2, Pika 2	Në fazën e parë, kandidati i interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit ka dërguar në DRAP, ku ka qendrën e banimit, dosjen e aplikimit për konkurrim.		

Kreu 2, Pika 3	Dosja e aplikantit është dërguar me postë, sipas afateve të përcaktuara nga DRAP-i.		
Kreu 2, Pika 4	Dosja e aplikimit përmban listën e dokumenteve sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.		
Kreu 2, Pika 5	Kandidati, dosja e të cilit nuk ka pasur dokumentet e detyrueshme sipas shtojcës 1, është përjashtuar nga të gjitha fazat e konkurrimit.		
Kreu 2, Pika 6	Kandidatit i është dhënë e drejta të konkurrojë deri në tri ZVAP-e.		
Kreu 2, Pika 7	Kandidati, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e fundi dhe konkurren përsëri, ka dërguar me postë në DRAP, ku kandidati ka qendrën e banimit, kërkesën për konkurrim sipas shtojcës 4, në të kundërt është përjashtuar nga portali.		
Kreu 2, Pika 8	Kandidati që ka qenë pjesëmarrës në portalin 2018 dhe dëshiron të ruajë pikët e dosjes, i janë konvertuar pikët sipas shtojcës 2, të këtij udhëzimi nga DRAP-i, pas transferimit të dosjes nga ZVAP-i, sipas kërkesës së DRAP-it. Kandidati ka paraqitur kërkesën për konkurrim sipas shtojcës 4, të këtij udhëzimi, në të kundërt është përjashtuar nga portali.		
Kreu 2, Pika 9	Kandidati, që ka qenë pjesëmarrës në portalin 2018 dhe ka dëshiruar të ruajë pikët e testimit të informatizuar, ka paraqitur kërkesën në DRAP për konkurrim sipas shtojcës 4, në të kundërt është përjashtuar nga portali.		
Kreu 2, Pika 10	Në fazën e dytë, “Testim i informatizuar”, kanë marrë pjesë kandidatët që janë regjistruar online në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe kanë kaluar me sukses fazën e parë “Vlerësim me dosje”.		
Kreu 2, Pika 12	Për të marrë pjesë në testimin e informatizuar, kandidati është pajisur me formularin e lëshuar nga Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve në DRAP, sipas shtojcës 3 të këtij udhëzimi, pranë ZVAP-it sipas vendbanimit.		
Kreu 2, Pika 13	Rezultatet e vlerësimit të dosjeve dhe të testimit të informatizuar për çdo kandidat janë bërë transparente nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të çdo DRAP/ZVAP-i dhe në portalin “Mësues për Shqipërinë”.		
Kreu 2, Pika 14	Administrimi i listës së kandidatëve është bërë nga DRAP-i dhe ZVAP-et, sipas renditjes dhe profileve të shpallura në portal nga DPAP-i.		
Kreu 3, Pika 1	Informacioni mbi aplikimet online të kandidatëve, shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve për mësues dhe pranimi në një vend të lirë pune, janë realizuar nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe në faqen elektronike zyrtare të DPAP-it.		
Kreu 4, Pika 1	Renditja e kandidatëve, të cilët kanë përfunduar të dy fazat e konkurrimit, ka filluar me kandidatin që ka më shumë pikë dhe ka vijuar me rend zbritës për çdo profil dhe çdo ZVAP.		
Kreu 4, Pika 3	DRAP-et dhe ZVAP-et kanë shpallur në faqen elektronike zyrtare dhe në stendat e informimit publik listat e kandidatëve të renditur sipas profileve, për institucionet arsimore të varësisë.		

Kreu 4, Pika 4	Për një vend të lirë pune, kandidati është njoftuar nga ZVAP-i, nëpërmjet postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit online dhe me dosje.		
Kreu 4, Pika 5	Kandidatit, i cili në renditjen e përgjithshme është renditur me numrin më të madh të pikëve, i është dhënë e drejta e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe detyrimisht ka konfirmuar në ZVAP brenda 24 orëve nëpërmjet adresës elektronike. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky pozicion pune i është ofruar kandidatit të listuar një rend më poshtë. Midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta, përparësi i është dhënë kandidatit që mund të jetë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka persona me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i punës i është ofruar kandidatit që ka rezultatin më të lartë në testim.		
Kreu 4, Pika 6	Çdo kandidati i është dhënë e drejta e refuzimit deri në pozicionin që ai ka preferuar. Refuzimi i vendit të punës nga kandidati është pasqyruar në portal nga ana e DPAP-it dhe e ZVAP-it, e cila ka informuar DRAP-in.		
Kreu 4, Pika 7	Kandidati fitues është paraqitur në institucionin arsimor menjëherë sapo ka marrë njoftimin. Ai i ka dorëzuar drejtorit të institucionit dokumentin vërtetues, të printuar nga sistemi i aplikimit online, në portalin “Mësues për Shqipërinë”.		
Kreu 4, Pika 8	Mësuesit ndihmës janë punësuar nga kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë” të profilit “Arsim special”, sipas procedurave të këtij udhëzimi.		
Kreu 4, Pika 9	Kandidati është punësuar nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës.		
Kreu 4, Pika 10	Kontrata e punës është nënshkruar ndërmjet kandidatit dhe drejtorit të institucionit arsimor.		
Kreu 4, Pika 11	DRAP-i, në fund të çdo muaji, ka njoftuar DPAP-in për punësimet e përhershme apo të përkohshme të bëra nga drejtorët e institucioneve arsimore në juridiksionin e saj.		
Kreu 4, Pika 12	Për të gjithë kandidatët, që kanë përzgjedhur një vend pune të përhershëm dhe janë emëruar me kontratë pune pa afat, është ndryshuar statusi i tyre në portal në statusin “I punësuar”.		
Kreu 4, Pika 13	Për të gjithë kandidatët, që kanë përzgjedhur një vend pune të përhershëm dhe janë emëruar me kontratë pune me afat, është ndryshuar statusi i tyre në portal në statusin “I punësuar përkohësisht”.		
Kreu 4, Pika 14	Në rast refuzimi të kandidatit fitues për vendin e lirë të propozuar, kandidati vazhdon të qëndrojë në renditje dhe i ofrohen vende pune të tjera të lira, deri në procedurat e hapjes së portalit të ri “Mësues për Shqipërinë”.		
Kreu 5, Pika 1	Kur në një ZVAP nuk ka pasur kandidatë të renditur në portal, sipas profilit që përkon me vendin e lirë të punës, janë njoftuar dhe janë emëruar ata kandidatë që janë të renditur në portal në		

	një profil të përafërt më profilin e kërkuar, duke respektuar procedurat e këtij udhëzimi.		
Kreu 5, Pika 2	ZVAP, për përcaktimin e profilit të përafërt të kandidatëve, është bazuar në udhëzimin e ministrit të MASR-së nr. 30, datë 12.09.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.		
Kreu 5, Pika 3	Kur nuk ka pasur kandidatë me profil të përafërt, DRAP-i ka njoftuar mësuesit e të njëjtit profil me profilin e kërkuar në të gjitha ZVAP-et nën varësi dhe është punësuar kandidati i renditur me numrin më të madh të pikëve, duke respektuar procedurat e këtij udhëzimi.		
Kreu 5, Pika 4, Gërma a	Nëse nga institucionet arsimore janë kërkuar mësues ndihmës në arsimin fillor, në mungesë të kandidatëve të profilit “Arsim special”, ZVAP-i ka njoftuar për punësim kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë” në profilin “Arsim fillor”, sipas renditjes.		
Kreu 5, Pika 4, Gërma b	Nëse nga institucionet arsimore janë kërkuar mësues ndihmës në arsimin e mesëm të ulët ose në arsimin e mesëm të lartë, në mungesë të kandidatëve të profilit “Arsim special”, ZVAP-i ka njoftuar për punësim kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë”, të të gjithë profileve sipas renditjes.		
Kreu 5, Pika 5	Në rast se në përfundim të procedurave të këtij kreu, ka rezultuar përsëri vend pune i lirë, ZVAP-i ka zhvilluar procedurat e konkurrimit me kandidatët e tjerë të interesuar, duke i renditur me pikë sipas nivelit të arsimit dhe profilit të përafërt me kërkesat e vendit të punës.		
Kreu 5, Pika 6	Kontrata e punës për kategorinë e mësuesve të përcaktuar në këtë kre, është lidhur me afat të caktuar, deri në momentin e paraqitjes së një kandidati nga portali “Mësues për Shqipërinë”.		
Kreu 6, Pika 1	DRAP-i ka krijuar Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve (KVD), me këtë përbërje: a) drejtori i DRAP-it (kryetar) b) një përfaqësues i sektorit të burimeve njerëzore, shërbimeve dhe statistikës (anëtar); c) dy përfaqësues të sektorit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional (anëtar); d) një mësues nga shkollat nën juridiksionin e DRAP-it, i cili ka të paktën kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist” (anëtar); e) një përfaqësues i prindërve (anëtar); f) një psikolog ose punonjës social që mbulon shkollat nën juridiksionin të DRAP-it (anëtar).		
Kreu 6, Pika 2	KVD ka përzgjedhur një apo më shumë anëtarë si sekretari teknike për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.		
Kreu 6, Pika 3	KVD ka zbatuar rregulloren e brendshme të tij, të miratuar nga drejtori i DRAP-it.		
Kreu 6, Pika 3,	KVD ka administruar dokumentacionin e kandidatëve për mësues.		

Gërma a			
Kreu 6, Pika 3, Gërma b	KVD ka njoftuar përfaqësuesit e bashkisë për pjesëmarrje, si dhe përfaqësuesit e sindikatave, si vëzhgues në mbledhjet e komisionit.		
Kreu 6, Pika 3, Gërma c	KVD ka shqyrtuar plotësimin e kriterëve ligjore të çdo kandidati për të ushtruar profesionin e mësuesit.		
Kreu 6, Pika 3, Gërma d	KVD ka vlerësuar me pikë, sipas shtojcës 2, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët.		
Kreu 6, Pika 3, Gërma e	KVD ka shqyrtuar rastet e mbartjes së pikëve apo përditësimit të dosjeve sipas deklaratave të kandidatëve.		
Kreu 6, Pika 3, Gërma f	KVD ka hartuar listën për çdo profil/lëndë sipas çdo ZVAP-i me ID-të përkatëse.		
Kreu 6, Pika 3, Gërma g	KVD ka publikuar në faqen elektronike zyrtare, pikët e dosjeve për çdo kandidat, me ID-në përkatëse, sipas profileve, për çdo ZVAP që ka në varësi.		
Kreu 6, Pika 3, Gërma h	KVD ka pajisur çdo kandidat me formularin e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar, sipas shtojcës 3, të këtij udhëzimi, nëpërmjet ZVAP-it.		
Kreu 6, Pika 3, Gërma i	KVD ka dërguar elektronikisht dhe zyrtarisht në DPAP listën përfundimtare me pikët e dosjes të çdo kandidati, sipas profileve dhe kandidatëve të skualifikuar		
Kreu 6, Pika 4	Dosjet e kandidatëve, për ushtrimin e profesionit të mësuesit, janë vlerësuar sipas skemës të përcaktuar në shtojcën 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.		
Kreu 6, Pika 5	Anëtari i KVD-së ka verifikuar dhe ka shmangur konfliktin e interesit me kandidatët, nëpërmjet deklaramit institucional.		
Kreu 7, Pika 1	Procedurat e lëvizjes paralele janë administruar nga ZVAP-i, vetëm në periudhën nga përfundimi i vitit mësimor deri në fillimin e vitit të ri mësimor.		
Kreu 7, Pika 2	Mësuesi që ka dëshiruar të kryejë lëvizje paralele, ka dërguar me postë në ZVAP kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar, sipas shtojcës 2.1, gjatë gjithë vitit mësimor.		
Kreu 7, Pika 3	Lëvizjet paralele janë kryer vetëm brenda ZVAP-it.		
Kreu 7, Pika 4	Për mësuesit që kanë mbetur pa ngarkesë mësimore, drejtori i institucionit arsimor ka dërguar në ZVAP listën emërore dhe vlerësimin e dosjeve të tyre, sipas shtojcës 2.1.		
Kreu 7, Pika 5, Gërma a/b/c	ZVAP ka krijuar komisionin e vlerësimit të dosjeve për lëvizje paralele, i përbërë nga: <ul style="list-style-type: none"> a. drejtuesi i ZVAP (kryetar); b. një specialist i kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP (anëtar); c. juristi i ZVAP (anëtar). 		

Kreu 7, Pika 6	Komisioni i vlerësimit të dosjeve në ZVAP, brenda muajit gusht, ka bërë vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele, sipas shtojcës 2.1.		
Kreu 7, Pika 7	Komisioni i vlerësimit ka shpallur renditjen e konkurrentëve për lëvizje paralele dhe paralele të detyrueshme, sipas pikëve në rendin zbritës. Renditja e mësuesve është shpallur në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-it.		
Kreu 7, Pika 8	Mësuesi, që është renditur me numrin më të madh të pikëve, i është dhënë e drejta të zgjedhë për vendin e lirë të punës. Ai ka dërguar brenda 24 orëve me email miratimin ose refuzimin e vendit të propozuar. Në rastin e moskonfirmimit nga kandidati, ky vend pune i është ofruar kandidatit të listuar një rend më poshtë.		
Kreu 7, Pika 9	Kur në institucion ka rënë numri i ngarkesës mësimore për një profil/lëndë, drejtori i shkollës ka krijuar komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve të atij profili/lënde.		
Kreu 7, Pika 10	Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë përbëhet nga: <ul style="list-style-type: none"> - drejtori i shkollës (kryetar); - një mësues i shkollës që vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në profesion (anëtar); - kryetari i këshillit të prindërve të shkollës (anëtar). 		
Kreu 7, Pika 11	Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë, ka vlerësuar dosjet e mësuesve të profilit/lëndës për të cilën bie numri i orëve sipas shtojcës 2.1, ka publikuar rezultatet me ID-të përkatëse dhe ka dërguar në ZVAP listën e mësuesve që mbeten pa ngarkesë me pikët e fituara nga vlerësimi i dosjeve.		
Kreu 7, Pika 12	Të gjithë mësuesve, që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe kanë mbetur të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u është ndërprerë marrëdhënia e punës, me të drejtën e konkurrimit sipas këtij udhëzimi.		
Kreu 7, Pika 13	Mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele dhe mësuesit që kanë rezultuar pa ngarkesë mësimore, në rastet kur janë punësuar në një vend pune të lirë, janë punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar.		
Kreu 8, Pika 1	Çdo kandidati i është dhënë e drejta e ankimit për vendimet e komisionit, në secilën prej procedurave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.		
Kreu 8, Pika 2	Ankimi i kandidatit është protokolluar në drejtorinë e institucionit ku është bërë ankimi, menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë pune pas shpalljes së tyre.		
Kreu 8, Pika 3	Ankimi është shqyrtuar nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune.		
Kreu 8, Pika 4	Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit, i është njoftuar ankuesit me shkrim nga institucioni.		

Kreu 8, Pika 5	Vendimet e institucioneve arsimore ankimohen tek organi epror, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.		
Kreu 9, Pika 1	Drejtori i shkollës ka marrë masën e pezullimit ndaj mësuesit, kur gjykata ka vendosur ndaj mësuesit masë të sigurimit personal, deri në vendimin e formës së prerë.		
Kreu 9, Pika 2	Mësuesit të pezulluar i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit.		
Kreu 9, Pika 3	Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit janë bërë sipas përcaktimeve në aktet e tjera nënligjore në fuqi.		
Kreu 9, Pika 4	Largimi i mësuesit nga puna është bërë sipas akteve nënligjore në fuqi.		
Kreu 10, Pika 1	Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra për zbatimin e këtij udhëzimi, janë ruajtur nga ZVAP/DRAP.		
Kreu 10, Pika 2	Për mësuesit në institucionet parashkollore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë kryer procedurat e emërimit, duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.		
Kreu 10, Pika 3	Dosjet e aplikimit të kandidatëve për mësues ruhen për 10 vite shkollore nga shpallja përfundimtare e rezultateve të konkurrimit. Dokumentet e tjera të përcaktuara në këtë udhëzim ruhen për 10 vjet.		